



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Departamenti i *Letërsi Gazetarisë në Fakultetin e Shkencave Humane* në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për nevojat e tij për zhvillimin e procesit mësimor për vitin akademik 2022-2023, shpall konkurs për personel akademik me kohë të pjesshme.

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet universitare (Ba dhe Master i Shkencave ose ekuivalente me të) në shkenca humane, fusha *Letërsi dhe Gazetari e Shkenca Komunikimi* brenda ose jashtë vendit, me notë mesatare mbi 8.0. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Në fushën e *Letërsisë*, të ketë titullin akademik **Profesor**. Në fushën e *Gazetarisë dhe Shkenca Komunikimi*, preferohet me gradën shkencore **Doktor i Shkencave**. Titujt/ Gradat e fituara brenda ose jashtë vendit e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri)
3. Të ketë përvojë dhe të jetë i angazhuar aktualisht në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor
4. Kandidati duhet të zotërojë të paktën një gjuhë të huaj të BE-së, e mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshmi (preferohet anglishtja).
5. Preferohet të ketë marrë pjesë në konferenca shkencore dhe të ketë botime shkencore
6. Të ketë kryer kurse apo trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushat e lartpërmendura.
7. Të jetë i/e gatshëm të përfshihet në mësimdhënie sipas orarit të përcaktuar nga drejtuesi i departamentit, sekretaria, pa kufizim kohor gjatë një dite mësimore.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **14.09.2022** deri **23.09.2022** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njësuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
4. Dokumentacionin shoqëruar përkatës origjinal ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti)
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës me gojë* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare 14.09.2022** deri **23.09.2022**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,
Rruga “Ismail Zyra”,
Aplikim në Fakultetin e Shkencave Humane
Departamenti i Letërsisë dhe Gazetarisë
Elbasan**